



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1016
Dt 13.09.2016

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 7.9.2016, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore për rritjen e numrit të studentëve për pranim në studimet bachelor-themelore, për vitin akademik 2016-2017:
 1. Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore +50 kandidatë;
 2. Programi Teknologji +40 kandidatë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Mitrovicës, pasi shqyrtoi kërkesën e dekanit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore për rritjen e numrit të studentëve në drejtimet e lartcekura, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, pasi duke u bazuar në përvojat e viteve të kaluara, në afatin plotësues ka pasur gjithmonë interesim të madh të kandidatëve për t'u pranuar në këto drejtime. Gjithashtu, duke u bazuar edhe në personelin akademik të angazhuar në procesin mësimor, hapësirat e mjaftueshme dhe laboratorët e pajisur me pajisje laboratorike, fakulteti ka kapacitet të mjaftueshëm për numrin e kërkuar të studentëve. Bazuar në këto që u thanë, Senati i Universitetit mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it

